

29 - 01 - 2019



[Handwritten signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:053162
Datë: 25.09.2018
Numri i dokumentit: 00129947

P.nr.2208/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykuës Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Mimoza Shabani Shabani, bashkëpunatore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1254-7/17 të dt. 05.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarit [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED], av. mbrojtës [REDACTED], me datën 01.09.2018 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datën 11.09.2018 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në Shkup, me vendbanim në Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me profesion teknik i makinerisë, i gjendjes së mesme ekonomike, prind i katër fëmijëve, Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës, mban nr. personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 28.05.2017. rreth orës 11:00, në rrugën [REDAKTUAR] në Ferizaj, me qëllim të frikësimit apo shkakimit të ankthit, ka kanosur seriozisht me fjalë, vepra dhe gjeste se të dëmtuarin [REDAKTUAR], në atë mënyrë që si pasojë e mosmarrëveshjeve të më hershme për shkak të kalimit të rrugës rreth shtëpisë së tij, i pandehuri ditën kritike posa e takon të dëmtuarin i cila ishte me veturën e tij, fillimisht ai pamundëson lëvizjen duke i dalë para veturës e më pas të njëjtës i drejtohet me fjalë se “mos mu sill këtu pari se të bëjë copa dhe ti njëhi 26 /njëzetegjashitë/ copë fishekë”. me ç'rast të dëmtuari me veprimet e tij ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

me këtë kreu veprën penale kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, e

G J Y K O N D Ë N I M M E B U R G

- Në kohëzgjatje prej 3 /tre/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- I dëmtuari: [REDAKTUAR] me vendbanim në rrugën “[REDAKTUAR]” pn. në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në procedure kontestimore.
- Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, të ligjit Nr. 05/L-036 për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro

/tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1254-7/17 të datës 05.09.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për veprën penale të kanosjes nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, konsideron se aktakuza është e bazuar mirë dhe e ligjshme, me të drejtë i propozon gjykatës të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptojë sanksion penal të paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 01.09.2018, përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri [REDAKTUAR] si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrën, në kuptim të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimit si në vijim:

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe vlersimi i tyre

I dëmtuari [REDAKTUAR] gjatë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur pranë deklaratës së dhënë në polici dhe vërteton nënshkrimin e tij, dëshmitari jeton në rrugën "[REDAKTUAR]" e cila rrugë lidhet edhe rrugët "Agim Ramadani" dhe "Kongresi i Manastirit" në Ferizaj, ditën kritike rrethe orës 11:00 deri sa ishte duke shkuar në shitore për të blerë ushqim, papritmas i pandehuri i del para veturës, ndërsa i dëmtuari ndalon veturën pasi për mos të vije deri te kontakti veturë-njeri, pas kësaj i dëmtuari ka dalë nga vetura ndërsa i pandehuri ka filluar të shaj me tonë të lartë, aty qëllon kalimthi një komshi me emrin [REDAKTUAR] dhe e largon nga vendi.

Dëshmitari në dëshminë e tij a më tutje vërteton se para se të largon komshiu të pandehurin, ky i fundit i thotë "prit këtu se do ti njechi 26 copë fishek-plumba", pas këtij kërcënimi i akuzuari fillon të ecë në drejtim të shtëpisë së tij (gjoja për të marrë diçka), ndërsa i dëmtuari shkon drejt e në Stacion Policorë për të lajmëruar rastin që mos të vij deri të më e keqja.

Dëshmitari pohon faktin se në vazhdimësi i akuzuari i ndal vëllezërit e tij, fëmijët dhe bashkëshortet e vëllezërve duke i ofenduar me fjalë banale, rruga është publike dhe sa herë që vejmë në pushime në Kosovë ne duhet të merremi me problemet e këtij për këtë i pandehuri e ka kaluar çdo kulë.

Gjykata, në rastin konkret vlerësoi se dëshmia e të dëmtuarit [REDAKTUAR] është objektive dhe besueshmëria e saj rritet për faktin se nuk përmban në vete zbrazëtirë apo mangësi logjike dhe e njëjta dëshmi plotësohet dhe mbështetet edhe nga provat tjera materiale si raporti i oficerit 2017-CF-1106 i dt. 28.05.2017, si dhe pjesërisht nga vetë dëshmia e të akuzuarit dhënë në procedurë parapenale me datën 28.05.2018 dhe atë në shqyrtimin kryesor.

Ndërsa raporti i oficerit 2017-CF-1106 i dt. 28.05.2017, vërteton se gjatë patrollimit të PK-Ferizaj, patrulla II, kanë pranuar informacionin nga lima kontroll për rast kanosje të dëmtuarit [REDAKTUAR], pas kësaj të akuzuarin [REDAKTUAR] e kanë shoqëruar në Stacion Policor që të merren veprimet e mëtejshme, ky raporte është i besueshëm dhe konsiston me provat tjera si dhe deklaratat e të dëmtuarit dhe vetë të pandehurit.

Mbrojtja e të pandehurit dhe vlersimi i mbrojtjes [REDAKTUAR]

I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici dhe konfirmon nënshkrimin e tij, shtonë se nuk qëndron kjo aktakuzë, nuk është e vërtetë se me datën 28.05.2018 ti ketë dalë para veturës së të dëmtuarit në rrugën “Kongresi i Manastirit”, kjo rrugë është private e cila evidentohet në emër të një personi me mërin [REDAKTUAR], kjo rrugë ka dalje në rrugën “Agim Ramadani” pasi që ky e ka liruar një pjesë të saj, në këtë rrugë kalon gjithë secili pa u penguar nga unë, ditën kritike është e vërtetë se ka takuar [REDAKTUAR] dhe se ky i fundit është ndalur vetë e që vetëm i ka thënë “ka e ke rrugën ti”, pasi që janë në hasmëri për rreth 10 vite, duke i kërkuar ta ndjek vetëm rrugën e tij a jo timen, fjalë të tjera nuk i ka thënë asgjë dhe nuk qëndron ajo se e kam kanosur me fjalë ti njëhi 26 copë fishek, pas këtij rasti e ka parë të dëmtuarin por nuk kanë pas probleme.

I pandehuri më tutje në mbrojtjen e tij pohon se rruga “Kongresi i Manastirit” është e kalueshme që 15 vite, kohët e fundit nuk është penguar askush në kalim të kësaj rruge, këtë rrugë e ka shtruar në asfalt Komuna e Ferizaj, ndërsa krejt në fund të mbrojtës së tij shton se: *“nuk dua të shoh aty pari [REDAKTUAR] dhe mos të kalon kësaj rruge”.*

Meqë i pandehuri mohon në tersi veprën penale dhe qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici me dt. 28.05.2017, Prokurori i Shtetit e ballafaqimin me pjesën respektivisht tekë pjesa pyetje-përgjigje, kur është pyetur në hetuesi: *“ae keni kërcënuar ju [REDAKTUAR]?”* I pandehuri është përgjigjur: *“i kam thënë mos i bir këtu pari mëm provoku se të bëjë copa...”*, pasi i pandehuri lexon me zë deklaratën e tij konfirmon se kjo është e vërtetë.

Gjykata çmtoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] se kinse nuk ka kanosur me fjalët mos u sill këtu pari se të bëjë copa dhe ti njëhi 26 copë fishek, por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti se nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] u vërtetua pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt se të akuzuarin fillimisht e ka takuar në vendin, kohën dhe datën e përshkruar si në dispozitiv, pastaj mënyrën se si i akuzuari e ka ndal veturën e të dëmtuarit, fyerjet që i janë bërë e më pas kanosjen e drejtë për drejt, prezencën e personave aty, dëshmitari në prezencën e të akuzuarit në seancën kryesore ka identifikuar të pandehurin, ka vërtetuar faktet relevante se është kanosur me fjalët *“mos mu sill këtu pari se të bëjë copa dhe ti njëhi 26 fijezetegjashtë/ copë fishekë”*, mënyrën se si ka ardhur deri te kanosja dhe sjelljen pas kanosjes kur i akuzuari është drejtuar për në shtëpinë e tij pasi të ketë thënë prit aty

(me rastin e kanosjes), i akuzuarit nuk ishte në gjendje që me pyetje dhe nën pyetje të demantojnë dëshmin e dëshmitarit dhe provave tjera materiale, për më tepër paralajmëron që i dëmtuari mos të bjer asaj rruge pasi që nuk dëshiron ta shoh, pra bëhet fjalë për rrugë publike, rrugë të cilën Kuvendi Komunal e ka asfaltuar, në këtë rast lind pyetje sikur kjo rrugë të ishte private siç pretendon i dëmtuari a do ta kishte asfaltuar Komuna pronën private (pa e shpronësuar edhe pse nuk ka dëshmi se është private rruga), sigurish që jo. Andaj nga frika se mos po vije deri të me e keqja menjëherë pas kanosjes kur i pandehuri i thotë prit dhe niset në drejtim të shtëpisë, i dëmtuari vetëm niset në stacion policor për të lajmëruar rastin.

Bazuar në dëgjimin e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor janë vërtetuar faktet relevante dhe atë koha, datën dhe vendin i kryerjes së veprës penale, dhe në aspektin juridik formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale të kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbet në tersi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale dhe se pas administrimit të provave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ky vërtetim është bërë nga deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] i cila në mënyrë të detajuar na vërtetoi se me dt. 28.05.2017, është kanosur nga i pandehuri edhe atë me fjalët "mos mu sill këtu pari se të bëjë copa dhe ti njëhi 26 /njëzetegjashtë/ copë lëshekë", si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të pandehurit i cili nuk e mohon faktin se ditën kritike e ka ndalur të pandehurin duke i bërë me dije që mos të kaloj aty pari se të bëjë copa, mbrojtjes së të pandehurit nuk duhet falë besimi sepse i njëjti përveç se nuk e pranon fajësinë nuk paraqiti asgjë bindëse për ti besuar, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor edhe ti shqiptoj një dënim të paraparë me ligj.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet prokurorin e shtetit si dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale, nuk paraqet kërkesë pasurore-juridike.

Mbrojtës i të pandehurit [REDAKTUAR], av. [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor e veçmas nga ushtrimi i provave dhe nga dëgjimi i të dëmtuarit nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

I pandehuri është akuzuar se ka kryer veprën penale nga neni 185 më konkretisht kanosjen e cila “kushdo që seriozisht e kanos tjetrin me fjalë apo vepra me qëllim të frikësimit apo shkakimit të ankthit”, pra në sensin e inkriminimit kanosja duhet të jetë serioze e drejtpërdrejtë dhe që do të shkakton pasojën menjëherë ose së shpejti e që në rastin konkret në asnjë pik nuk u vërtetua dhe nuk u diskutua se kjo kanosje ishte serioze e po ashtu edhe vet i dëmtuari nuk deklaroi se nga veprimet e të akuzuarit është ndier i frikësuar, këtë rrethanë e vërteton faktin se i dëmtuari ka kaluar edhe disa herë në këtë rrugë nuk është ndier i frikësuar apo rrezikuar se do të ndodhë më e keqja. Meqenëse kryerja e kësaj vepre penale inkriminohet nga shkaktimi i frikësimit apo ankthit e të cilat veprime nuk janë shkakuar tek i dëmtuari, vërtetohet se nuk është kryer vepra penale në fjalë dhe i propozon gjykatës të pandehurin ta liron nga akuza.

I pandehuri [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare deklaroi se në tersi e mbështet avokatin e tij.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese të cilat ishin të natyrës ekskluzivisht personale se i akuzuari është i padënuar deri tani me aktgjykim të formës së prerë, moshën e shtyrë kurse këto rrethana i ndërlidhi me sjelljen e tij korrekte gjatë procedurës penale, kurse në rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e rrezikshmërisë dhe peshën e kësaj vepre penale si dhe përgjegjësisë penale për të pandehurit, rrethanat familjare, i dëmtuari jeton në afërsi me shtëpi me të pandehurin dhe janë në marrëdhënie familjare dhe mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënim si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Megjithatë, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit është e bindur se me anë të këtij dënimeve është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, dhe se me anë të këtyre dënimeve do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore juridik edhe shpenzimet procedurale

Sa i përket kërkesës pasurore-juridike, gjykata të dëmtuarën nuk udhëzon në kontest juridiko-civil, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, për faktin se heq dorë i dëmtuari.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Obligohen të akuzuarit që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimt, të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2208/2017 dt. 11.09.2018.

B. Profesionale
Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.